

Moti i keq në ndërtimtari**Stop në rast rreziku!**

Të ftohtit e madh, toka dhe skelet e ngrira, bora dhe moti i ftohtë me lagështi, e rrisin rrezikun e fatkeqësisë dhe dëmtojnë shëndetin e punëtorëve të ndërtimtarisë.

Kontrata e Përgjithshme Kombëtare (KPK) thotë: «Në rast të kushteve të këqija atmosferike, të cilat rrezikojnë shëndetin e punëmarrësve [...] (shiu, bora, vetëtimja, acari), punët në ambient të hapur duhet të ndërpriten.» **Dhe: Punëtorët e ndërtimtarisë duhet të konsultohen se kur duhet të ndërpritet puna në kantier.**

Edhe Ligji përcakton qartë: Punëdhënësi është përgjegjës për shëndetin e punëtorëve. **Ai duhet të ndërpresë punën në rast të motit që dëmton shëndetin e punëtorëve.**



- **Punëtorët e ndërtimtarisë e dinë më së miri, kur është i rrezikuar shëndeti i tyre.**
- **Moti i keq është një rrezik për ndërmarrjen. Dhe kjo nuk guxon të bartet mbi kurrizin e punëtorëve të ndërtimtarisë!**
- **Orët e humbura duhet të paguhen. Ndërprerjet e shkurtëra mund të kompensohen me orë shtesë jashtë orarit. Por nuk lejohet që pushimet të caktohen me shpejtësi apo në mënyrë retroaktive!**
- **Nëse shëndeti juaj është rrezikuar nga moti i keq: Lajmërohu tek sindikata!**

